

KOMUNIKATË PËR PUBLIKUN

28 qershor, 2021

Pas më shumë se një viti prej inicimit të rastit kundër avokatit Tomë Gashi për shkelje etike është mbajtur shqyrtimi kryesor në Komisionin Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Në shkurt të vitit 2020, avokati Tomë Gashi kishte shkëluar gjësendet e një personi që kërkonte lëmshë në sheshin Nënë Tereza, i cili i përket njërit nga komunitetet jo-shumicë. Rasti ishte mbuluar nga kamerat e vendosura në sheshet Zahir Pajaziti, Nënë Tereza e Ibrahim Rugova, e poashtu edhe nga kalimtarët e rastit.

Më 3 mars 2020, Youth Initiative for Human Rights - Kosovo (YIHR KS) kishte paraqitur parashkresë për hapjen e procedurës disiplinore pranë Odës së Avokatëve të Kosovës për avokatin Tomë Gashi dhe kishte kërkuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor nisjen e procedurës së pavarur profesionale hetimore, cilësimin e veprimit të avokatit si shkelje e rëndë disiplinore dhe shqiptimin e masës “humbje e të drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatisë për 4 vite”.

Me ndihmën e ekipit të YIHR KS, përfaqësuesit Leutrim Himaj nga zyra e avokatisë “Leutrim Syla” B.I me përfaqësim pro bono, BIRN Kosovo si dhe me ekspertë tjerë të jashtëm u realizua prezantimi i mbrojtjes së parashtrësës së inicuar për rastin në fjalë.

Që nga iniciimi i rastit tek Oda e Avokatëve të Kosovës, YIHR KS në vazhdimësi ka përcjellur rrjedhën e rastit dhe ka kontaktuar Odën e Avokatëve të Kosovës për më shumë se 10 herë me radhë. Falë insistimit konsistent, rasti është pranuar të trajtohet me urgjencë.

Ne e konsiderojmë trajtimin e duhur të këtij rasti me rëndësi strategjike për shoqërinë tonë dhe komunitetet jo shumicë në përgjithësi. Marrja e licencës apo cilido dënim i shqiptuar ndaj avokatit në fjalë do të kontribuonte në mospërsëritjen e sjelljeve të tilla joetike të avokatëve dhe personave të tjerë publikë.

Duke parë rëndësinë e shkeljes së dyshuar, ne shpresojmë se Oda e Avokatëve do të marrë parasysh të gjitha provat e prezantuara fajësuese dhe shfajësuese, në mënyrë që rasti të shqyrtohet sa më parë që është e mundur brenda afateve ligjore dhe në formë të drejtë për të gjitha palët në procedurë.

Së fundi, YIHR KS falenderon të gjithë ekipin e mbrojtjes për përgatitjen e rastit dhe aktivizmin e treguar.